



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1113/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e Emine Sheholli kandidate për asamble të kuvendit komunal nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Podujevë, paraqitur kundër Komisionerëve të subjektit politik PDK-së, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Emine Sheholli kandidate për kuvendin komunal në Podujevë nga radhët e subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Emine Sheholli anëtare për asamble komunale nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në komunën e Podujevës, në të cilën ajo thekson se në disa vendvotime iu janë konfirmuar votat nga votuesit e saj, por të njejtat nuk gjenden e në rezultatin e këtyre vendvotimeve në fshatin Bajqinë në qendrën e votimit 1808e/01R dhe 1808e/02D, në shkollën Naim Frashëri në vendvotimin 1802x/01R si dhe 1802x/02R. Po ashtu në fshatin Lladofc në qendrën e votimit 1838e/01D, në fshatin Pollatë 1805e/01R dhe 02R, dhe në fshatin Kërpimeh në qendrën e votimit 1804e/01R, 1804e/02R dhe në shkollën “Isa Boletini” në vend votimin 1824e/02R, mendon se në të gjitha këto vendvotime duhet të bëhet rinumrimi i votat.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesës Emine Sheholli nga komuna e Podujevës. PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të

Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1113/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetkatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.